



Funded by
the European Union



Tri thesare unike të endura në pëlhurën e natyrës përrallore shqiptare

“Triada e Arbanonit: Një projekt për trashëgiminë kulturore dhe natyrore”

REC Shqipëri ka nisur zbatimin e një projekti që synon të promovojë dhe dokumentojë tre monumente unike të gjendura në Shqipërinë e Mesme, në disa prej qendrave kryesore të shtetit të parë mirëfilli shqiptar, Principatës së Arbrit. Duke i lidhur këto tre monumente, ne do të krijojmë një katalog udhëtimesh që pasqyron historinë, kulturën dhe vlerat natyrore të tyre. Ai do të shërbejë si një udhërrëfyes i pasur për të gjithë ata që dëshirojnë të eksplorojnë thesaret kulturore të Shqipërisë, si dhe do të ndërthurë rëndësinë e të pasurit të një perspektive të shtuar natyrore krahas asaj kulturore në përvoja të tilla turistike.

Le t'i eksplorojmë së bashku tre objektet në fjalë, sipas reflektimeve të dy ekspertëve që po punojnë me qëmtimin e vlerave të kombinuara historiko-kulturore dhe natyrore të tyre.

Ura e Kurçajve, Bashkia Krujë



Prof. Ols Lafe (Ph.D. në Menaxhim të Trashëgimisë Kulturore) realizon një pëshkrim interesant të objektit të fshehur në hinterland-in e Krujës: E vendosur në gjarpërimin e një lugine, Ura e Kurçajt është një monument i rëndësishëm historik dhe arkitektonik, që lidh brigjet e lumit Zezë i cili buron nga Qafa e Shtamës, në Bashkinë e Krujës. Ajo ka qenë pjesë e rrugës së hershme të karvaneve që lidhte Krujën me fushën e Tiranës nëpërmjet itinerarit Barkanesh-Kurçaj-Buronjë-Mukaj-Rradhesh-Zallherr. Ura përbëhet nga harku gjysëm rrethor dhe nga dy dritare anësore. Në thembrat e qemerit të madh ruhen vrimat e trarëve të poshtëm të armaturës së harkut. Ura e Kurçaj mendohet nga studiuesit të jetë ndërtuar në shekullin e XVIII-të, periudhë gjatë të cilës në territoret e Shqipërisë së sotme janë ndërtuar shumë ura guri përgjatë rrugëve me kalldrëm. Kalldrëmi origjinal ruhet në krahun e djathtë të urës dhe mbi të ai ka parapet sigurie me mur guri.

Kjo urë përfaqëson mjeshtërinë e ndërtimit të asaj kohe, duke ofruar një shembull të qartë të arkitekturës të periudhës osmane. Pas dëmeve të pësura nga tërmeti shkatërrimtar i vitit 2019, ura është restauruar dhe përfaqëson një vend të preferuar jo vetëm për historianët dhe studiuesit e fushës, por edhe për turistët që vijnë për të shijuar natyrën dhe qetësinë e kësaj zone. Përveç rëndësisë së saj arkitektonike, ura është edhe një dëshmitare e heshtur e historive të shumta të udhëtarëve që kanë kaluar mbi të gjatë shekujve.

E teksta njihemi me vlerat historiko-kulturore, Prof. Asoc. Mihallaq Qirjo (Ph.D. në biologji mjedisore dhe ekspert i zhvillimit të qëndrueshëm) na sjell disa përcaktime lidhur me atributet natyrore të vend-pozicionimit të këtij objekti: Monumenti gjendet në eko-rajonin kodrinor të Shqipërisë së Mesme. Zona karakterizohet nga terren i lartë i tipit kodrinor-malor, i cili mbart një larmi të madhe vegjetative dhe faunore. Pyjet e dushkut (*Quercus spp.*) dhe ahut (*Fagus sylvatica*) mbizotërojnë në këto rajone, duke krijuar një mozaik habitatesh që strehojnë lloje të rralla shtazore si shqiponja e artë (*Aquila chrysaetos*) dhe kaprolli (*Capreolus capreolus*). Në këto lartësi, bimësia përshtatet me klimën më të freskët dhe të lagësht, duke përfshirë edhe barishte aromatike si trëndafili i egër (*Rosa canina*) dhe livandën (*Lavandula angustifolia*).

Ky rajon është i njohur për rolin e tij si një rezervuar natyror për ruajtjen e burimeve ujore dhe mbështet biodiversitetin e qëndrueshëm. Shtresat e pasura me humus dhe terrenet e pjerrëta krijojnë kushte të favorshme për bimët shumëvjeçare dhe ato pyjore, duke e bërë këtë zonë një thesar natyror për studimet ekologjike dhe shkencore.

Kisha e Manastirit të Rubikut (Kisha e Shëlbuesit të Vjetër), Bashkia Mirditë



E ndodhur në zemër të Rubikut, Kisha e Manastirit është një dëshmi e gjallë e artit dhe shpirtit mesjetar shqiptar. Në gjendjen e sotme kisha i takon disa periudhave ndërtimore. Sipas Prof. Lafes, kisha e vjetër është kishë manastiri dhe përmendet në dokumente të hershme që në vitin 1166, ndërkohë që në latinisht ruhet një mbishkrim që mban datën e pikturimit të kishës në vitin 1272. Ndërtimi është drejtëkëndësh në plan dhe me një absidë gjysmë rrethore në lindje. Ndërtesa me arkitekturë të thjeshtë por mbresëlënëse, është e vendosur në një kodër të qetë, që ofron një pamje magjepsëse të luginës përreth. Kjo kishë ka shërbyer për shekuj si qendër shpirtërore dhe kulturore, duke qenë një pikë e rëndësishme referimi për komunitetet vendase.

Arkitektura e kishës transmeton elementë të parimeve stilistikore romanike ndërsa afresku brenda kishës përfaqëson mjeshtërinë e lartë artistike bizantine, por me mbishkrime shoqëruese në latinisht duke treguar ndërthurje të kulturës perëndimore dhe asaj lindore. Kisha shërben gjithashtu si një simbol i vazhdimësisë së besimit dhe traditave fetare ndër shekuj në krahinën e Mirditës. Pozita gjeografike e saj, në një kodër që dominon mjedisin përreth, krijon një lidhje harmonike midis njeriut dhe natyrës, duke tërhequr jo vetëm besimtarë por edhe dashamirës të arkitekturës dhe peizazheve, vendas sikundër dhe të huaj. Objekti gëzon një qasje panoramike të rrjedhës së poshtme të Luginës së Lumit Fan, përpara konvergencës së këtij të fundit me Lumin Mat.

Prof. Qirjo, duke u ndaluar te kjo e fundit, shprehet se Lugina e Fanit, me peizazhin e saj të gjerë dhe rrjedhat e pastra të ujit, është një nga zonat më të rëndësishme ekologjike në Shqipërinë veriore. Karakterizohet nga një bimësi e përzier që përfshin pyje halorë si pisha (*Pinus nigra*) dhe bredhi (*Abies alba*), të cilat gjenden kryesisht në zonat më të larta, dhe bimësi më e ulët si shqopa (*Fraxinus ornus*) dhe shega e egër (*Punica granatum*) pranë brigjeve të lumit.

Lugina shquhet për mikroklimën e saj unike, që krijon kushte ideale për rritjen e bimëve endemike dhe atyre të rëndësishme për mjedisin. Për më tepër, Lumi Fan është një habitat i rëndësishëm për amfibët dhe peshqit e ujërave të ëmbla, duke luajtur një rol kyç në mbajtjen e ekosistemeve lokale të shëndetshme. Terrenet përreth ofrojnë gjithashtu mundësi për kullotjen tradicionale, duke mbështetur praktikën e qëndrueshme të bujqësisë në rajon.

Kisha e Shna 'Ndout, Bashkia Durrës



Kisha e Shna 'Ndout (Saint Anthony) në Kepin e Rodonit është një nga monumentet më të spikatura të trashëgimisë kulturore në Shqipëri, thekson Prof. Lafe. Sipas tij kisha ishte një abaci Benediktine në kohën e Regnum Albaniae në fund të shekullit të XIII-të dhe më pas e rikompozuar nga urdhri Françeskan gjatë shekullit të XV-të. Kisha është e lidhur ngushtë me historinë e Gjergj Kastriot Skënderbeut, më saktë të motrës së tij Mamicës, e cila sipas traditës françeskane ndërtoi një manastir pranë saj, shprehet Prof. Ols Lafe.

E vendosur pranë bregut të Adriatikut, në një peizazh të mrekullueshëm ku ujërat blu të detit i lënë vendin kodrave të rrumbullakosura dhe të gjelbëruara, kisha prezanton një bashkëjetesë të në arkitekturë dhe pikturë të elementëve të repertorit bizantin dhe latin. Me strukturën e saj të thjeshtë

dhe atmosferën e qetë, ajo tërheq jo vetëm besimtarë, por edhe vizitorë të apasionuar pas historisë dhe natyrës. Ndërthurja e artit dhe kulturës me prezantimin e shqiponjës dykrenore të pikturuar në akreskun brenda kishës, shtojnë edhe më shumë kërkshërinë e vizitorëve për këtë objekt kulturi.

Për sa i përket kësaj të fundit, Prof. Qirjo thekson se objekti gjendet në eko-rajonin e Gjirit të Lalzit dhe Kepit të Rodonit, i cili përfaqëson një peizazh të pasur mesdhetar, ku dominojnë shkurret tipike të quajtura “makie” mesdhetare. Këto përbëhen kryesisht nga bimësi e dendur si murrizi (*Pistacia lentiscus*), dafina (*Laurus nobilis*), dhe rigoni i egër (*Origanum vulgare*), që mbulojnë terrenet e ngritura dhe të thata të kësaj zone. Klima e ngrohtë mesdhetare dhe afërsia me Adriatikon krijojnë kushte ideale për një biodiversitet të pasur. Gjiri i Lalzit është gjithashtu një habitat i rëndësishëm për shpendët ujorë dhe migrues, të cilët ndalojnë gjatë rrugëtimit të tyre në ligatinat përreth.

Sipas Prof. Mihallaq Qirjo, zona ka një rëndësi të veçantë ekologjike, pasi ndërthur ekosistemet bregdetare me ato të brendshme, duke shërbyer si një korridor natyror për shumë specie. Kepi i Rodonit, me shkëmbinjtë e tij të lëmuar, ofron një vend ideal për rritjen e bimësisë endemike dhe rezistente ndaj erozionit, ndërsa lagunat dhe hapësirat pranë bregut janë të rëndësishme për mbijetesën e florës halofile.

Ky artikull është përgatitur nga Qendra Burimore e Mjedisit në Shqipëri, në kuadër të programit EU4Culture, financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga UNOPS në partneritet me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Qendrës Burimore të Mjedisit në Shqipëri dhe nuk reflekton medoemos pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe/ose UNOPS.